



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DIVJAKË

DREJTORIA JURIDIKE PROKURIMEVE PUBLIKE DHE MENAXHIMIT TË
ASETEVE

Nr. 3997 Prot.

Divjakë, më 11.05.2026.

PROJEKT - VENDIM

Nr. 41, datë 11.05.2026.

“MBI MIRATIMIN E PËRFUNDIMIT TË PROCEDURËS SË PRIVATIZIMIT TË BANESAVE TË CILAT KANË MBETUR PA U REGJISTRUAR NË AGJENCINË SHTETËRORE TË KADASTRËS, DREJTORIA VENDORE LUSHNJE, PËR LIDHJEN E KONTRATAVE PARA NOTERIT”.

Mbështetur në Ligjin Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, (i ndryshuar), me VKM nr. 97 datë 03.02.2008, “Për procedurat e privatizimit të banesave shtetërore objekt i Ligjit nr. 7652 datë 23.12.1992 dhe Ligjit nr. 9321 datë 25.11.2004 “Për trajtimin e banesave dhe objekteve të kthyer në banesa me fondet e Shoqërive dhe Ndërmarrjeve Shtetërore”, pika 5, pika 27 dhe 37 nenet 1 dhe 2, VKM numër 179, datë 26.02.2020, “Për rregullat, kushtet dhe procedurat e privatizimit të banesave që kanë qënë subject i Ligjit 7652, datë 23.12.1992,”Për Privatizimin e Banesave Shtetërore”, si dhe në Dekretin e Presidentit nr. 1440 datë 04.04.1996 “Për trajtimin e banesave shtetërore të paprivatizuara neni 1 dhe neni 2, si edhe neni 192 i Kodit Civil i Republikës së Shqipërisë paragrafi II, regjistrimi i Pasurive të Paluajtshme të bëhet në bazë të një akti public, të një vendimi gjyqate apo të një organi tjetër shtetëror kompetent, si edhe në raste të tjera të parashikuara në ligj, si edhe neni 193/b i Kodit Civil, i propozojme Keshillit të Bashkisë Divjakë, me datë 25.05.2026:

- 1- Të miratojë përfundimin e procedurës së privatizimit të banesave të cilat kanë mbetur pa u regjistruar pranë Zyres së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për lidhjen e kontratave para noterit për qytetaret që kanë aplikuar sipas listes së mëposhteme emerore:
 - **Ibrahim Hamit Kolonjari**, lindur në Qerret, Elbasan, banues në Grabjan, me adresë ,Grabjan, ndertesa numer 064, hyrja numer 1, Apartamenti numer 1, ka aplikuar dhe ka paraqitur dokumentacionin përkatës për apartamentin e ndodhur në Pallatin numër 32 Grabjan, Shk --, Kati II, e përbere nga 2 dhoma dhe 1 kuzhine, me aneks në fshatin Grabjan, Zona Kadastrale 1827, i gjithë dokumentacionin ndodhet në dosjen e privatizimit.
- 2- Për zbatimin e këtij Projekt - Vendimi ngarkohet Sektori Juridike dhe i Prokurimeve Publike.

Juristi:

Andi Bullari

